



Planuar / Dorezuar Priljezo / Priljezo Received / Delivery		26.05.2021		viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPINSHK	2647/2021		119	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.324/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.3049/2019 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.627/2019 të datës 14.10.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Rruga "Anton Harapi" SU 2/10, nr.13 në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit-Administratës Tatimore të Kosovës në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.05.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 627/2019 e datës 14.10.2019 e parashtruar nga ankuesi dhe vendosur sipas Aktgjykimit A.nr.3049/2019 të datës 15.04.2021.

**A r s y e t i m**

Ndaj, Ankuesit sipas Akt emërimit të datës 12.08.2015 i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitën "Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit në Departamentit e Tatimpaguesve të Mëdhenj", Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës ka nxjerrë vendimin numër Nr.11/510 A të datës 07.08.2019 për transfer të përkohshëm nga pozita "Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit në Departamentit e Tatimpaguesve të Mëdhenj" në pozitën "Zyrtar i Lartë për Ligjin e Administratës tatimore dhe Procedurat në Departamentin e Kontrollit dhe Procedurat për periudhën kohore nga data 07.08.2019 deri më datë 07.02.2020.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin numër Nr.11/510 A të datës 07.08.2019 për transfer të përkohshëm me datë 30.08.2019 ka ushtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.



Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka nxjerrë vendimin me numër nr..11/190 të datës 18.09.2019 me të cilin ankesën e ankuesit të datës 30.08.2019 e ka aprovuar pjesërisht duke e obliguar Organin e Punësimit që të bëjë ndryshimin e vendimit me numër protokoll nr.11/510A të datës 08.08.2019 të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës dhe të ndryshojë bazën ligjore mbi të cilën është nxjerrë vendimi.

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës me datë 23.09.2019 nxjerrë vendimi e ri me numër Nr.01/730 me të cilin e bënë plotësim-ndryshimin e vendimit numër Nr.11/510 A të datës 07.08.2019 për transferim e përkohshëm të nëpunësit civil z.

Administrata tatimore e Kosovës në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 10.09.2019, me datë 16.09.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Udhëheqës Ekipi ATK-Kontrolli (3pozita)", ndërsa ankuesi në këtë konkurs nuk ka aplikuar pasi që e konsideron së është shpallur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase ankuesi për pozitën në fjalë është i emëruar me akt emërimit e datës 12.08.2015 dhe sipas ligjit kjo pozitë ruhet me rastin e transferit të përkohshëm.

Ankuesi, i pakënaqur me shpalljen e konkursit të brendshëm nga Administratat Tatimore e Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.10.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër protokoll 4829/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.10.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Administratat Tatimore e Kosovës. Administratat Tatimore e Kosovës më datë 30.10.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 20.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.53049/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 20.11.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 14.10.2019.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4829/2019 të datës 14.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit të datës 10.08.2015; E-mailin e datës 16.09.2019 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.10.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 30.10.2019; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil i datës 10.09.2019; Raportin final të rekomandimit nga Komisioni rekrutues i datës 04.10.2019 me numër prot: 891; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 08.10.2019; E-mailin e datës 16.09.2019; Struktura e Përgjithshme Organizative e Administratës Tatimore; Rregullorja nr. ATK-13/2019 e datës 17.05.2019; E-mailin e datës 01.08.2019 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 01.08.2019 \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Vendimin me numër Nr.11/510A i datës 06.08.2019; Vendimin me numër Nr:1/730 i datës 23.09.2019; Ankesën e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 30.08.2019 me nr:11-06-3465; Vendimi numër 11/190 i datës 18.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Konkursin e brendshëm i datës 16.09.2019; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 23.09.2019; Njoftimi i kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i datës 27.09.2016; Aktgjykimin me numër A.nr.3049/2019 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.04.2021; Emaili i datës 24.05.2021 i dërguar nga ankuesi në cilësinë e përgjigjes dhënë kërkesën e datës 24.05.2021 dërguar nga Zyrtari i Lartë Për Bashkëpunim profesional i KMPSHCK-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative në lidhje me këtë ankesë është bërë i pamundur apo i kotë andaj edhe mbi këtë bazë ligjore kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 97 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku shprehimisht thuhet se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ ...", që në rastin konkret procedura administrative e nisur kundër Vendimit Nr.01/730 të datës 23.09.2019 ka përfunduar mbi bazë të njoftimit/emailit të datës 21.12.2020, të konfirmuar përmes shkresës/emailit zyrtarë të datës 12.05.2021 nga Burimet Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës përmes së cilit fakt kolegji ka konstatuar se transferimi i nëpunësit civil \_\_\_\_\_ tashmë ka përfunduar pasi nëpunësi civil/ankuesi është kthyer në pozitën e mëparshme sipas Akt Emërimit të datës 10.08.2015 me numër të protokollit 02/244/09 "Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit në Departamentin e Tatimpaguesve të mëdhenj".

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 104 ku është përcaktuar se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë", andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se procedura administrative e iniciuar nga ankuesi \_\_\_\_\_ përmes ankesës me numër A.nr.619/2019 të parashtruar me datë 14.10.2019 është bërë i pamundur apo i kotë, respektivisht





vendimi i goditur me ankesë është shfuqizuar dhe si i tillë nuk prodhon pasoja juridike ne raport me ankuesin andaj edhe kanë pushuar arsyet ligjore që të vendoset ndryshe nga siç është vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i cili përcakton se: “Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit është konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës ka nxjerrë vendimin A.nr.366/2021 të datës 18.05.2021 me të cilin ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga ankuesi

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshilla juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.324/2021**

**Flakron Gashi**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

